



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 4 prot.

Tiranë, më 4.1.2024

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 15.1.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Ylli Bashaj

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.6.2023, është njoftuar vendimi nr. 671, datë 14.6.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ylli Bashaj, prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar Komisioni), me vendimin nr. 671, datë 14.6.2023, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c<sup>1</sup>” të aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 65, pika 2<sup>2</sup> e ligjit nr. 84/2016, një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar ONM), kanë paraqitur, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, aktin nr. 411/1 prot., datë 30.6.2023: “Rekomandim për paraqitje ankimi”. Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2 të aneksit të Kushtetutës, dhe

---

<sup>1</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: “u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim”. <sup>2</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit.

Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, në konsideratë edhe të Rekomandimit të ONM-së, ka vlerësuar se ai përmban shkaqe ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, juridiksion i cili lejon Kolegjin që të përcaktojë ligjërisht çdo rrethanë fakti nën parashikimet e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Sa më sipër, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të paraqitura në ankimin e datës 12.7.2023, Komisioneri Publik, parashtron sa në vijim:

*1. Për pasurinë apartament me sip. 93,09 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “\*\*\* \*\*\*” Tiranë, nga hetimi administrativ ka rezultuar se:*

1.1 Në D-Vetting, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, ndër të tjera, kanë deklaruar pasurinë: [...] *Apartament<sup>2</sup> me sip. 93,09 m<sup>2</sup>, blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*/\*\*\*, datë \*\*.12.2000, për vlerën 28.000 USD. Vlera e asetit 28.000 USD, e shlyer tërësisht. Burimi: (i) 10.000 dollarë, kursime nga të ardhurat; (ii) 10.000 dollarë, marrë kredi në formën e borxhit, nga të afërmit dhe miqtë dhe (iii) 10.000 dollarë, marrë kredi nga Banka \*\*\*-\*\*\*, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*.02.2001 [...].*

1.2 Në DV-2003, dorëzuar në ILDKPKI, datë 10.5.2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Apartament në qytetin e Tiranës, 2+1, vlera 28.000 dollarë, sip. 93 m<sup>2</sup>, rr. “\*\*\* \*\*\*” nr. \*\*\*/\*\*.* Blerë privatisht nga “\*\*\* \*\*\*” sh.p.k. Burimi i krijimit deklarohet: (i) 13.000 USD (dollarë amerikanë) kursime; (ii) 2.000 USD (dollarë amerikanë) \*\*\* \*\*\*, vëllai; (iii) 2.000 USD (dollarë amerikanë) \*\*\* \*\*\*, djali i xhaxhait; (iv) 1.500 USD (dollarë amerikanë) \*\*\* \*\*\*, Tiranë; (v) 1.500 USD (dollarë amerikanë) \*\*\* \*\*\*, Vlorë; (vi) 10.000 dollarë, Banka \*\*\*-\*\*\* në vitin 2001.

1.3 Lidhur me deklarin dhe çmimin e blerjes së kësaj pasurie, nga aktet e administruara<sup>3</sup> në dosje gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, ka rezultuar si vijon:

1.3.1 Me kontratë shitje nr. \*\*\*/\*\*\*, datë \*\*.12.2000, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shoqëria “\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., apartament me sipërfaqe 93,09 m<sup>2</sup>, Tiranë, me çmim shitblerje 28.000 USD<sup>4</sup>. Në përmbajtje të kontratës së shitblerjes, *palët deklarojnë se shuma 28.000 USD është likuiduar jashtë zyrës noteriale, pa pretendime nga palët, si dhe në gjendjen dhe në kushtet që ajo ndodhet.*

<sup>2</sup> Subjekti ka depozituar: (i) Certifikatë për Vërtetim Pronësie; (ii) Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., dt. \*\*.12.2000; (iii) Kontratë Financimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., dt. \*\*.2.2001, midis Bankës \*\*\*-\*\*\* dhe Ylli Bashaj.

<sup>3</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*.12.2020, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; Shkresë “kthim përgjigje” ASHK Tirana Veri, nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.12.2020; Shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2022, drejtuar shoqërisë “\*\*\* \*\*\*” sh.p.k.; Shkresë “kthim përgjigje” e shoqërisë “\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., nr. \*\* prot. datë \*\*.12.2022.

<sup>4</sup> Subjekti i rivlerësimit është pajisur me certifikatë pronësie, datë \*\*.12.2018, për këtë pasuri të regjistruar me nr. \*\*/\*\*\*\*+\*\*\*\*-\*\*\*\*, zonë kadastrale \*\*\*\*, me sipërfaqe totale 87.09 m<sup>2</sup>. Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, rezulton se, fillimisht, ai është pajisur me Certifikatë pronësie dt. \*\*.12.2016, e cila përmban të dhëna jo të sakta të atësisë dhe mbiemrit të tij (Ylli \*\*\* Basha) dhe më tej, me urdhër të brendshëm, është kryer saktësimi i të dhënave dhe lëshimi i certifikatës së saktë të pronësisë, datë \*\*.12.2018.

1.3.2 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament në muajin mars të vitit 2000. Në përgjigje të pyetjes së Komisionit, në pyetësorin e datës 31.10.2022, i pyetur në lidhje me aktin ligjor përmes së cilit ai ka banuar në këtë apartament nga muaji mars, duke konsideruar që kontrata e shitjes është lidhur në muajin dhjetor të vitit 2000, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *nuk ka pasur një akt të tillë specifik ... Thjesht ka qenë një marrëveshje verbale me administratorin, të cilit i kam garantuar gjithashtu se do të bëja pagesën e plotë, për shlyerjen e vlerës së blerjes të apartamentit, qoftë edhe përmes aplikimit për të përfutur kredi bankare [...].*

1.3.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të datës 31.10.2022, ka bashkëlidhur Vërtetimin nr. \*\* prot., datë \*\*11.2022, të shoqërisë “\*\*\* \*\*” sh.p.k., nënshkruar nga administratori \*\*\* \*\*, i cili, në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, si person i interesuar, lidhur me vlerën e shlyerjes së kësaj pasurie, ndër të tjera, referon se: [...] *Për apartamentin e sipërcituar, blerësi, z. Ylli Basha, ka paguar në favor të shoqërisë “\*\*\* \*\*” sh.p.k., vlerën totale 28.000 \$, nga të cilat 20.000 \$ janë paguar nëpërmjet arkës së shoqërisë dhe pjesa tjetër prej 8.000 \$ është paguar me bankë [...].*

1.3.4 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij janë financuar nga Banka \*\*\*-\*\*\* (aktualisht \*\*\* \*\* Bank), me kontratën e kredisë bankare nr. \*\*\*/\*\*, datë \*\*.2.2001, për shumën 8.000 USD, me afat 48-mujor, me qëllim financimi “*blerje apartamenti*”. Kjo kredi rezulton të jetë disbursuar në llogarinë e subjektit në datën \*\*.2.2001 dhe po në këtë datë është transferuar në llogarinë bankare të shoqërisë “\*\*\* \*\*” sh.p.k., me përshkrimin: “\*\*\* \*\* për pagesën e kështit të fundit, për blerjen e apartamentit”, rreth dy muaj më vonë se data e përcaktuar në kontratën e shitjes.

1.3.5 Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë “\*\*\* \*\*” sh.p.k., në lidhje me marrëdhënien e shitblerjes së realizuar me subjektin e rivlerësimit. Shoqëria, në përgjigje të kërkesës së Komisionit<sup>5</sup>, datë \*\*12.2022, ndër të tjera, ndryshe nga sa ka konfirmuar për subjektin në vërtetimin e datës \*\*.11.2022, është përgjigjur se: [...] *Blerësi Ylli Basha, me anë të kontratës së shitjes që disponojmë, me datë \*\*.12.2000, me nr. \*\*\* rep./\*\*\* kol., ka blerë në këtë godinë një apartament banimi me sip. të përgjithshme 93,09 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 28.000 USD. Duke qenë se nga momenti i kryerjes së pagesave nga Blerësi, ka kaluar një kohë relativisht shumë e gjatë, prej 22 vitesh, shoqëria “\*\*\* \*\*” sh.p.k., në funksion edhe të ligjit për Kontabilitetin dhe Tatimet, nuk i kemi më të ruajtura këto dokumentet e asaj periudhe... Kalimi i pronësisë dhe regjistrimi i pronës apartament me të dhënat sipas kontratës së shitjes, datë \*\*.12.2000, është kryer pas përfundimit të procedurave të regjistrimit, fillimisht, në emër të shoqërisë në datën \*\*.10.2000, e më pas në emër të subjektit përfutues [...].*

1.4 Komisioni, bazuar në përmbajtjen e kontratës së shitjes, nga e cila rezulton se deri në datën e nënshkrimit të saj është likuiduar vlera 28.000 USD, si dhe dokumentacionin bankar, nga i cili provohet se, në datën \*\*.2.2001, subjekti ka transferuar në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*

---

<sup>5</sup> Në përgjigjen e nënshkruar nga administratori, \*\*\* \*\*, është vënë në dispozicion të Komisionit: (i) kopje të kontratës së shitblerjes së lidhur me subjektin e rivlerësimit; (ii) vërtetimi hipotekor, datë \*\*.10.2000, për regjistrimin e objektit “8-katësh”, në emër të shoqërisë ndërtuese, si dhe (iii) kopje të aplikimit të kryer nga subjekti pranë ZVRPP-së, në datë \*\*.4.2001, për regjistrimin e pasurisë në emër të tij dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

\*\*\*” sh.p.k. vlerën 8.000 USD, ka vlerësuar se, në total, subjekti i rivlerësimit ka paguar në favor të shoqërisë “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k. vlerën 36.000 USD, si dhe ka vlerësuar, deri në këtë moment, se çmimi 28.000 USD do të konsiderohet i likuiduar deri në datën e nënshkrimit të kontratës, \*\*12.2000, në përputhje me disponimin që vetë palët kanë bërë në përmbajtje të aktit të shitblerjes.

1.5 Komisioni ka hetuar edhe në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese<sup>6</sup>. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>7</sup>, në përgjigjen e vënë në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, ka informuar se subjekti ka hetuar procedimin penal nr. \*\*\*/2015, për veprën penale: “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve \*\*\*. \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\*.

1.6 Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasit \*\*\* \*\*\* dhe dërgimin e çështjes penale në gjykim për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, në ngarkim të shtetasit \*\*\*. \*\*\*.

1.7 Shtetasi \*\*\* \*\*\* rezulton i emëruar në cilësinë e administratorit të shoqërisë “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., me vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë datë \*\*.6.2021, me afat emërimi \*\*.6.2021- \*\*.6.2026. Ky shtetas ka firmosur në këtë cilësi në vërtetimet e lëshuara nga shoqëria “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., drejtuar Komisionit dhe vetë subjektit të rivlerësimit, të sipërcituara.

1.8 Komisioni, lidhur me këtë situatë faktike, bazuar në datën e emërimit të shtetasit \*\*\*. \*\*\*, në cilësinë e administratorit, ka konkluduar se procedimi i këtij shtetasi nga subjekti i rivlerësimit nuk është kryer në kushtet e konfliktit të interesit. Gjithsesi, procedimi penal, nr. \*\*\*/2015, është analizuar nga Komisioni dhe është pjesë e Raportit të aftësive profesionale, hartuar nga KLP-ja, si një nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, konkretisht dosja nr. \*\*, e këtij raporti.

1.8.1 Nga aktet nuk duket se Komisioni ka konstatuar problematika në analizimin e këtij procedimi. Gjithsesi, subjekti i rivlerësimit, në pyetësin plotësues nr. 2, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.2.2023, ka dhënë shpjegime mbi veprimet hetimore të kryera në lidhje me këtë procedim. Nuk duket që rasti të jetë trajtuar apo referuar më tej në vendimin e Komisionit nr. 671/2023.

1.9 Në përfundim, lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë *apartment* me sip. 93,09 m<sup>2</sup>, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi duket se për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka paguar vlerën 28.000 USD, të likuiduar deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, si dhe vlerën 8.000 USD, të transferuar nëpërmjet bankës në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., në datën \*\*.2.2001, në total në

---

<sup>6</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.1.2023, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë \*\*.1.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 1.1 Nga informacioni i administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pranë së cilës subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën në vitet 1998-2002, që përkon me periudhën e nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe likuidimin e çmimit të kësaj kontrate, nuk rezultojnë procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit në emër të shoqërisë “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., administratorit të kësaj shoqërie në periudhën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, shtetasit \*\*\* \*\*\* dhe bashkëshortes së tij, shtetases \*\*\* \*\*\*.

<sup>7</sup> Referohuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të paraqitur nga subjekti, në përgjigje të Pyetësorit datë 31.10.2022.

shumën 36.000 USD, shumë të cilën Komisioni e ka përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën deri në vitin 2001<sup>8</sup>.

1.10 Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit mbi vlerën e blerjes së apartamentit, trajtuar gjerësisht në ankim.

1.11 Në përfundim, Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe pretendimet e tij, vlerësoi se: [...] *ato duhet të merren në konsideratë, në tërësi me: (i) deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike, të cilat, në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë për këtë proces; (ii) veprimet e subjektit për likuidimin e kësaj pasurie, si dhe me (iii) kontratat e ngjashme të lidhura nga shoqëria me blerës të tjerë. ... Subjekti ka qenë konsistent në deklaratimet e tij në deklaratat periodike, në Deklaratën "Vetting", por edhe gjatë hetimit administrativ, ku ai ka deklaruar si çmim blerjeje për këtë apartament shumë 28.000 USD. Ai ka kryer të gjitha përpjekjet për të provuar këtë pagesë, duke depozituar edhe vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë \*\*.11.2022, të shoqërisë "\*\*\*\*. \*\*\*\*." sh.p.k., në përmbajtje të të cilit shoqëria deklaron se blerësi i apartamentit ka paguar vlerën totale 28.000 USD, nga të cilat 20.000 USD janë paguar nëpërmjet arkës së shoqërisë dhe pjesa tjetër, prej 8.000 USD, është paguar me bankë [...].*

1.12 Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së dhe në drejtim të vlerësimit të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të subjektit me provat e administruara, ku: (1) sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë të lidhur mes palëve, më datë \*\*.12.2000, referohet se çmimi është shlyer totalisht jashtë zyrës noteriale, si dhe (2) të dhënat bankare dëshmojnë se edhe një vlerë prej 8.000 USD ka kaluar në llogarinë e shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k., më datë \*\*.2.2001, shtron si shkak ankimi faktin që duket se vlera e paguar për blerjen e pasurisë *apartament* me sipërfaqe 93,09 m<sup>2</sup>, është 36.000 USD, dhe jo 28.000 USD.

1.13 Përgjigjet e subjektit në pyetësin e datës 31.10.2022, si dhe vërtetimi nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2022, bashkëlidhur këtij pyetësi, i lëshuar nga shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., me kërkesë të subjektit, nënshkruar nga administratori \*\*\*, \*\*\*, për të cilin duket se subjekti në procedimin penal nr. \*\*\*/2015 ka pushuar hetimet në ngarkim të tij, nuk duket se janë akte që krijojnë bindjen për të arritur në nivelin e provueshmërisë, lidhur me vlerën e saktë të blerjes së kësaj pasurie.

1.14 Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, duke pasur parasysh kompetencat e Kolegjit, si organi që kontrollon vendimmarrjen e Komisionit, edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me kuadrin ligjor të zbatueshëm, vlerëson se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, duhen rivlerësuar nga Kolegji në drejtim të arritjes së konkluzionit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie.

**2. Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, atë të deklaruar kredi në formën e borxhit nga të afërm dhe miqtë, rezulton se subjekti i rivlerësimit, për pasurinë *apartament* me sip.**

---

<sup>8</sup> Në këtë logjikë, nga analiza financiare e kryer nga Komisionit, duke konsideruar si shpenzim për blerjen e pasurisë në vitin 2000 shumë 28.000 USD dhe për vitin 2001 shumë 8.000 USD, i ka rezultuar pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për pagesën e vlerës prej 28.000 USD, në vitin 2000, në shumë – 1.665.100,80. Për më tepër referohuni Rezultateve të hetimit administrativ.

93,09 m<sup>2</sup>, në Deklaratën “Vetting”, ka deklaruar si burim të ardhurash për krijimin e tij, ndër të tjera, dhe 10.000 dollarë, marrë kredi në formën e borxhit, nga të afërmit dhe miqtë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore të viteve në vijim, shlyerjen e këtyre huave dhe/ose vlerat e mbetura të detyrimeve financiare<sup>9</sup>.

2.1 Komisioni, duke marrë për bazë deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ për sa i përket burimeve që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, ka hetuar në lidhje me burimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe mundësinë e huadhënësve, për t’i dhënë subjektit huat e deklaruara, dhe i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka konstatuar se:

*[...] Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të huadhënësit \*\*\*. \*\*\*, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën 2.000 USD, në vitin 2000. Komisioni nuk e ka konsideruar huamarrjen nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*, si burim për blerjen e pasurisë apartament.*

*Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të huadhënësit \*\*\*. \*\*\*, nga puna si avokat, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas në vlerën 1.500 USD, në vitin 2000, sipas deklaratimit të subjektit. Komisioni nuk e ka konsideruar huamarrjen nga shtetasi \*\*\*. \*\*\*, si burim për blerjen e pasurisë apartament.*

*Nga analiza financiare duket se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në vlerën 1.665.100,80<sup>10</sup> lekë, për pagesën e shumës 28.000 USD, në datën e nënshkrimit të kontratës [...].*

2.2 Pasi ka analizuar shpjegimet e subjektit dhe aktet bashkëlidhur, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *[...] Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit \*\*\*. \*\*\*, për rrjedhojë, huaja në shumën 2.000 USD nuk do të përfshihet në analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti... subjekti i rivlerësimit munda të provojë se huadhënësi \*\*\*. \*\*\*, ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas dhe vendosi ta përfshijë këtë hua në analizën financiare për blerjen e pasurisë apartament [...].*

2.2.1 Lidhur me mosdeklarimin e shlyerjes së huave, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar kujdesin e nevojshëm për deklarimin e detyrimeve financiare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. Në kushtet kur këto pasaktësi rezultojnë në deklaratat periodike, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>11</sup>, ato nuk mund të shërbejnë si indikatorë për procesin e rivlerësimit të subjektit<sup>12</sup>.

<sup>9</sup> Në përgjigje të Pyetësorit Standard, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*/9.2020, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar huamarrje në vlerën totale prej 7.000 USD, nga shtetasi \*\*\* \*\*\*, \*\*\* \*\*\*, \*\*\* \*\*\*, dhe \*\*\* \*\*\*. Në lidhje me kthimin e këtyre huave, subjekti ka deklaruar se huaja e marrë nga shtetasi \*\*\* \*\*\*, është shlyer pjesë-pjesë dhe tërësisht, deri në vitin 2007, huaja e marrë nga shtetasi \*\*\* \*\*\*, është shlyer tërësisht në fund të vitit 2004, huaja e marrë nga shtetasi \*\*\* \*\*\*, është shlyer tërësisht pas vitit 2004 dhe huaja e marrë nga shtetasi \*\*\* \*\*\*, është shlyer pjesë-pjesë deri në vitin 2007.

<sup>10</sup> Referuar analizës të Komisionit në konsideratë të vlerës së blerjes së pasurisë prej 36.000 USD.

<sup>11</sup> Vendimet nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020, nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020 dhe nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020, të Kolegjit.

<sup>12</sup> Gjithsesi, Komisioni ka përfshirë në analizë financiare kthimin pjesor të huas ndaj shtetasi \*\*\*. \*\*\*, në periudhën prill 2002 – 2007 dhe kthimin pjesor të huas ndaj shtetasi \*\*\*. \*\*\*, në periudhën 2004 – 2007, sipas deklaratimeve të subjektit gjatë

2.2.2 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, në konsideratë të pretendimit të subjektit mbi çmimin e blerjes së apartamentit në shumën 28.000 USD, paguar 20.000 USD në vitin 2000 dhe 8.000 USD në vitin 2001, si dhe përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të huas nga shtetasi \*\*\*, \*\*\*, i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shumën -133.220,34 lekë, për pagesën e kështit prej 20.000 USD, të çmimit të apartamentit në vitin 2000. Kjo pamjaftueshmëri është konsideruar se nuk përbën shkak që deklarimi i subjektit të konsiderohet i pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

2.2.3 Komisioni ka kryer edhe një analizë hipotetike, duke e konsideruar çmimin e blerjes së këtij apartamenti në shumën 36.000 USD, analizë nga e cila i ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme blerjen e këtij apartamenti në shumën - 1.274.340,34 lekë. Për këtë pamjaftueshmëri, Komisioni ka arsyetuar se, edhe sikur për një moment të merret si vlerë e apartamentit shuma 36.000 USD, mungesa e mjeteve financiare është e tillë që, bazuar në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelit për raste të ngjashme, nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra<sup>13</sup>.

2.3 *Komisioneri Publik*, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së dhe në analizë të akteve të administruara në funksion të hetimit administrativ, vlerëson se, përveç mospërputhjeve të deklarimeve mbi shumat e huave nga individët e mësipërm në deklaratën e vitit 2003 dhe atë “Vetting”, mbetet i provuar mosdeklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, i ecursisë së marrëdhënies së huave dhe shlyerjeve të tyre. Këto marrëdhënie interesi të krijuara mes palëve duhet të ishin deklaruar rregullisht që nga momenti i krijimit dhe deri në shuarjen e tyre, në deklaratimet periodike të subjektit pranë ILDKPKI-së.

2.4 Në këto rrethana, *Komisioneri Publik* vlerëson se: (1) deklaratimet kontradiktore lidhur me shumat e marra hua; (2) mosdeklarimet nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të shlyerjes së tyre, si dhe (3) mungesa e provueshmërisë me dokumentacion provues lidhur me marrjen, kthimin dhe, më së paku, në një rast i mundësisë financiare të huadhënësit për të mundësuar dhënien e huas, janë rrethana që duket se duhen të analizohen dhe rivlerësohen nga Kolegji, në kuptim të efekteve juridike në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 84/2016.

2.5 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, në gjendjen që janë aktet në dosje, është i nevojshëm rivlerësimi nga Kolegji i zërave të analizës financiare lidhur me vlerën reale të blerjes së pasurisë dhe burimeve të ligjshme të deklaruara nga subjekti si burim krijimi për këtë pasuri, kryesisht huat nga personat e tjerë të lidhur dhe mundësisë financiare të tyre për të dhënë huat e deklaruara.

2.6 Gjithashtu, në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, Komisioneri Publik arsyeton se proporcionaliteti vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte në drejtim të

---

hetimit administrativ, analizë nga e cila ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e huave ndaj huadhënësve \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*, \*\*\*.

<sup>13</sup> Komisioni ka referuar dhe paragrafin 96 të vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), S. vs Albania, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, Komisioni vlerëson se kjo shumë nuk klasifikohet si deklarim i pamjaftueshëm për të shërbyer si shkak autonom për shkarkimin e subjektit nga detyra.

pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision apo atij në Kolegj. Negativiteti i konstatuar në rastin konkret lidhet me një pasuri të vetme në momentin e blerjes së saj dhe nuk shtrihet në vite dhe, si i tillë, ka nevojë t'i nënshtrohet juridiksionit rivlerësues të Kolegjit, në drejtim të përcaktimit të saktë të nivelit të ligjshmërisë së burimeve të subjektit të rivlerësimit dhe pasojën që sjell në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë.

### **3. Lidhur me shkollimin e vajzës së subjektit, znj. \*\*\*. \*\*\*, në Itali, për periudhën tetor 2013 - prill 2014**

3.1 Në DV-2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *shpenzime për studimet e vajzës në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e \*\*\* - Itali*. Po në të njëjtën deklaratë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: *pakësim në vlerën 1.400.000 lekë nga banka \*\*\* dhe \*\*\* nga të ardhurat nga pagat*, ndërsa në seksionin e të dhënave konfidenciale, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *shpenzime për studime të vajzës në shumën 1.400.000 lekë, banesë, ushqim*.

3.2 Komisioni, në verifikim të deklaratave periodike vjetore, dhe të llogarive bankare ka konstatuar tërheqjen e shumës totale 1.400.000 lekë dhe, ndër të tjera, i ka kërkuar subjektit, në pyetësoin e datës 31.10.2022, të informojë Komisionin nëse vajza e tij ka çelur llogari bankare në Itali dhe, nëse po, të vërë në dispozicion të hetimit lëvizjet e kësaj llogarie.

3.3 Në vijim, Komisioni në rezultatet e hetimit, ka arsyetuar se, pavarësisht kërkesës së Komisionit për të depozituar dokumentacion bankar<sup>14</sup>, si dhe vënies në dukje të faktit që mosdorëzimi i dokumentacionit do të konsiderohet si mungesë bashkëpunimi, subjekti, sërish, ka refuzuar të depozitojë nxjerrjet e llogarive të vajzës së tij në Itali për periudhën e rivlerësimit dhe në vijim. Për sa më sipër duket se subjekti, me mosveprimet e tij, reflekton mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

3.4 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë konstatim, bashkëlidhur parashtimeve të tij<sup>15</sup>, ka paraqitur lëvizjet e llogarisë bankare të vajzës, \*\*\*. \*\*\*, në \*\*\* \*\*\* Itali, për vitet 2021 – 2022.

3.5 Komisioni, pasi ka analizuar shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, duke konsideruar faktin se shkollimi i vajzës së tij në shtetin italian ka zgjatur vetëm për 1 semestër shkollor dhe shpenzimet e kryera për këtë shkollim janë deklaruar saktësisht nga subjekti, si dhe janë provuar me dokumentacion provues, ka arsyetuar se i vlerëson bindëse shpjegimet e tij në lidhje me këtë konstatim. Komisioni verifikoi edhe lëvizjet e llogarisë bankare të vajzës së subjektit në \*\*\* \*\*\* Bank, për periudhën 2021 – 2022, dhe konkludoi se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me lëvizjet bankare të vajzës së tij.

3.6 Komisioneri Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së dhe në analizë të akteve të administruara, konstaton se dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nuk është në formën e caktuar ligjore, që të konsiderohet me vlerë provuese gjatë gjykimit për

---

<sup>14</sup> Subjekti, ndër të tjera, ka paraqitur dokument nga \*\*\* \*\*\* Bank Itali, për pajisjen e shtetasës \*\*\* \*\*\* me kartën bankare, i cili nuk përmban emërtim, datë dhe të dhëna mbi llogarinë bankare të \*\*\* \*\*\* pranë kësaj banke, si dhe fotografim nga aparat celular lidhur me njoftimet e mbërritura në rrugë elektronike për kalimin e pagës mujore.

<sup>15</sup> Për më shumë, referohuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.



efekt të procesit të rivlerësimit, për të krijuar bindjen se në llogarinë e vajzës së subjektit të rivlerësimit ka kaluar vetëm bursa e shkollës.

4. Si përfundim, Komisioneri Publik, në të tilla rrethana, brenda kompetencave të tij kushtetuese, në zbatim dhe të Rekomandimit të ONM-së, vlerëson se shkaqet e ankimit në vlerësimin e kriterit të pasurisë, do të duhet të gjejnë përgjigje gjatë vlerësimit të çështjes në Kolegj, si organ rivlerësimi që Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor.

#### **Kërkimi i ankimit**

5. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

6. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

7. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 671, datë 14.6.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose
- Lënien në fuqi të këtij vendimi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**